



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. 1423/Prot.  
11

Tiranë, më 22.04.2021

**VENDIM**  
Nr. 171, datë 22.04.2021

**PËR**  
**MIRATIMIN E “KODI I ETIKËS GJYQËSORE”**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbështetje të neneve 147 dhe 147/a, pika 1, shkronja “ç”, të Kushtetutës të Republikës të Shqipërisë, të nenit 83/1 të Ligjit Nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, të nenit 4, pika 3 të Ligjit Nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me propozim të Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale,

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e “Kodi i Etikës Gjyqësore”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**

**KRYETARË**

**NAUREDALLAGAMI**



## KODI I ETIKËS GJYQËSORE

Duke marrë parasysh standardet e njohura ndërkombëtarisht mbi të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të cilat në mënyrë të veçantë i garantojnë secilit barazinë para ligjit, prezumimin e pafajësisë dhe të drejtën për gjykim të drejtë dhe publik brenda një kohe të arsyeshme nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e themeluar me ligj;

Duke respektuar Parimet Themelore të Kombeve të Bashkuara për Pavarësinë e Gjyqësorit, të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara;

Duke iu referuar Rekomandimit CM/Rec (2010)12 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për gjyqtarët në lidhje me pavarësinë, efikasitetin dhe përgjegjësitë; duke u mbështetur tek Rekomandimet e Kievit të OSBE-së për pavarësinë e gjyqësorit në Evropën Juglindore, Kaukazin Jugor dhe Azinë Qendrore (2010) dhe duke i adoptuar objektivat të cilat ato shprehin;

Duke marrë parasysh Kartën Evropiane mbi Statutin e Gjyqtarëve dhe Memorandumin Shpjegues të saj të përgatitur nga Këshilli i Evropës;

Duke marrë parasysh Parimet e Bangalore për Sjelljen Gjyqësore, miratuar nga Grupi Gjyqësor për Forcimin e Integritetit Gjyqësor (2002), Magna Carta-n e Gjyqtarëve të miratuar nga Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Evropianë (2010), Kartën e Gjyqtarëve në Evropë, miratuar nga Shoqata e Gjyqtarëve Evropianë (1997) dhe Kodin Global të Etikës Gjyqësore të Bolonjës dhe Milanos, miratuar në Konferencën Ndërkombëtare për Pavarësinë Gjyqësore (2015);

Duke pranuar se një gjyqësor i pavarur, efektiv dhe i paanshëm është i domosdoshëm për të dhënë drejtësi në një shoqëri demokratike, për të forcuar sundimin e ligjit dhe për të garantuar liritë individuale të çdo individi dhe akses të barabartë në gjykatë;

Të vetëdijshëm për domosdoshmërinë që dispozitat që synojnë të sigurojnë garanci më të mira për kompetencat, pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqtarëve të plotësohen me një kod të etikës gjyqësore,

Këshilli i Lartë Gjyqësor përcakton standardet e etikës gjyqësore dhe rregullat e sjelljes së gjyqtarëve, si më poshtë:

### **I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

1. Standardet e etikës gjyqësore dhe rregullat e sjelljes të gjyqtarit, në vijim Kodi i Etikës Gjyqësore, janë tërësia e parimeve, normave dhe rregullave, të cilat udhëheqin sjelljen e gjyqtarit gjatë ushtrimit të detyrës dhe veprimtarisë së tij jashtëgjyqësore.
2. Kodi i Etikës Gjyqësore synon të garantojë rritjen dhe forcimin e besimit të publikut në sistemin e drejtësisë dhe dhënien e drejtësisë në përputhje me Kushtetutën, standardet e njohura ndërkombëtarisht të të drejtave të njeriut dhe ligjin.
3. Gjyqtari duhet të ruajë dhe zbatojë standarde të larta të sjelljes dhe duhet t'i respektojë personalisht këto standarde, në mënyrë që integriteti dhe pavarësia e gjyqësorit të ruhen. Dispozitat e këtij Kodi duhet të interpretohen dhe zbatohen për të arritur këtë objektivi.
4. Kodi i Etikës Gjyqësore zbatohet nga të gjithë gjyqtarët e sistemit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë. Pjesë të këtij Kodi, të cilat kanë të bëjnë me jetën private, kanë natyrë këshillimore dhe zbatohen, për aq sa është e mundur, edhe nga gjyqtarët e komanduar në pozicione të tjera.

5. Rregullat e këtij kodi zbatohen për aq sa është e mundur edhe për nëpunësit civilë gjyqësorë në gjykata, për këshilltarët ligjorë si dhe ndihmësit ligjorë. Të gjithë subjektet ndaj të cilëve zbatohen rregullat e përcaktuara në këtë kod, duhet të marrin masa që të rregullojnë menjëherë marrëdhëniet dhe veprimtarinë e tyre në pajtim me rregullat e këtij Kodi.

## II. PARIMET BAZË TË KODIT TË ETIKËS GJYQËSORE

### A. Parimi i Pavarësisë

6. Gjyqtari përgjigjet vetëm përpara ligjit. Ai i përmbush detyrat e tij i lirë nga çdo ndikim i jashtëm dhe është i pavarur nga pushtetet e tjera, nga grupet e interesit dhe nga palët gjatë gjykimit të një çështjeje. Gjyqtari nuk është i detyruar t'i sqarojë qëndrimet e tij ligjore dhe gjendjen e vërtetuar të fakteve, përveçse kur arsyeton vendimin gjyqësor ose kur kjo i kërkohet për shkak të ligjit. Sipas këtij parimi gjyqtari:
  - a) respekton dhe punon për një gjyqësor të pavarur, si në aspektin individual ashtu edhe në aspektin institucional;
  - b) kujdeset gjithmonë që sjellja e tij, zyrtare apo private, të mos cenojë pavarësinë individuale apo institucionale të gjyqësorit dhe as dukjen e pavarësisë në sytë e publikut. Gjyqtari duhet të shmangë sjelljet që mund të krijojnë përshtypjen te publiku se është i angazhuar politikisht dhe as të marrë pjesë në aktivitete politike, në çfarëdo lloji mënyrë, me përjashtim të çështjeve me rëndësi për funksionimin e gjykatave dhe pavarësinë e tyre;
  - c) nuk duhet të japë kontribute financiare apo kontribute të tjera subjekteve politike dhe as të nënshkruajë peticione që ndërmerren nga subjekte politike;
  - ç) kujdeset që të jetë i pavarur nga kolegët e tij. Ai mund të këshillohet me kolegët gjyqtarë, por përgjegjësia në vendimmarrje është vetëm e tij;
  - d) duhet të mos ndikohet nga reagimi publik, që mund të shkaktojë veprimtaria e tij;dh) mund të refuzojë gjykimin e një çështjeje ku mund të vihet në diskutim pavarësia e tij, pavarësisht nëse kjo kërkohet apo jo nga palët.

### B. Parimi i Paanshmërisë

7. Në kryerjen e detyrave gjyqësore gjyqtari është i paanshëm dhe duhet të duket i tillë. Gjyqtari gjykon me paanësi, i lirë nga çdo lidhje, prirje ose paragjykim që ndikon, ose mund të duket se ndikon, në aftësinë e tij për të gjykuar në mënyrë të paanshme. Në këtë kuptim, paanësia duhet të jetë e dukshme gjatë ushtrimit të funksioneve gjyqësore të gjyqtarit dhe aktiviteteve të tjera të tij në jetën private. Sipas këtij parimi gjyqtari:
  - a) merr masa që sjellja e tij në gjykatë dhe jashtë saj të garantojë dhe rrisë besimin e publikut, praktikuesve të tjerë të ligjit dhe të palëve tek vetë gjyqtari dhe gjyqësori;
  - b) shmang çdo lloj sjelljeje që mund të krijojë përshtypjen e anshmërisë;
  - c) nuk duhet të lejojë që gjykimi i tij të ndikohet nga presioni, frika, mendimi personal apo paragjykimi, nga ide paraprake mbi çështjen që ka për gjykim dhe as të promovojë në mënyrë të papërshtatshme interesat e një pale, në dëm të palës tjetër;
  - ç) shmang situatat që në mënyrë të arsyeshme mund të perceptohen se çojnë drejt një konflikti interesi;
  - d) mund të mos marrë pjesë në gjykimin e një çështjeje nëse ai çmon se nuk është në gjendje të gjykojë në mënyrë të paanshme ose një vëzhguesi të arsyeshëm mund t'i krijohet përshtypja që gjyqtari nuk është në gjendje ta gjykojë çështjen në mënyrë të paanshme;dh) brenda kufijve të arsyeshëm, vepron në mënyrë të tillë që të minimizohen rastet ku do të jetë i nevojshëm përjashtimi i tij nga gjykimi i çështjes;

- e) përveç rasteve të parashikuara me ligj, gjyqtari nuk duhet të iniciojë, lejojë apo të konsiderojë komunikimin *ex parte* jashtë seancës gjyqësore. Në rast se ndodh një komunikim i tillë, gjyqtari e ndan informacionin përkatës me palët e tjera të përfshira dhe kur është e mundur, siguron pjesëmarrjen e tyre, duke u dhënë mundësinë për t'u shprehur, nëse kërkohet;
- ë) duhet të tregojë vetëpërmbajtje në mbështetjen publikisht apo shprehjen e kritikave të çfarëdo lloji dhe natyre ndaj pushteteve të tjera, përveç çështjeve që lidhen me reformën dhe funksionimin e gjyqësorit;
- f) duhet të shmanget nga bërja e komenteve mbi çështje të diskutueshme politike apo deklarata publike, të cilat mund të krijojnë përshtypjen se gjyqtari është i njëanshëm ose i ndikuar në një çështje të caktuar;
- g) duhet të jetë i kujdesshëm në marrëdhëniet që krijon për shkak të anëtarësisë së tij në shoqatat e gjyqtarëve, apo në shoqata kulturore, sportive, fetare ose të fushave të tjera duke shmangur ato marrëdhënie që mund të komprometojnë respektimin e imazhit të tij ose të sistemit gjyqësor;
- gj) nuk duhet të pranojë dhurata, favore apo përfitime, për veten apo të afërmit e tij, të tilla që mund të venë në diskutim paanshmërinë e tij;
- h) nuk lejon që banesa apo çdo ambient privat në posedim faktik prej tij të përdoret nga avokatët ose praktikues të tjerë të ligjit për të pritur klientët e tyre.

### C. Parimi i Integritetit

- 8. Gjyqtari sillet gjithmonë në mënyrë të tillë që të ruajë dinjitetin, përgjegjësitë në funksion dhe paanshmërinë e pavarësinë e gjyqësorit. Sjellja dhe qëndrimi i gjyqtarit duhet të rikonfirmojë besimin e qytetarëve tek integriteti i gjyqësorit. Sipas këtij parimi, gjyqtari:
  - a) kujdeset për ruajtjen e integritetit si gjatë ushtrimit të detyrës, ashtu dhe në jetën e tij private, me qëllim garantimin e besimit të publikut tek sistemi gjyqësor;
  - b) sigurohet që sjellja e tij të jetë dinjitoze në sytë e një vëzhguesi të arsyeshëm;
  - c) nuk lejon që marrëdhëniet familjare, shoqërore apo të tjera, të ndikojnë në mënyrë të papërshtatshme në sjelljen apo ushtrimin e detyrës së tij;
  - ç) duhet të udhëhiqet nga mirësjellja dhe ndershmëria profesionale, korrektesa në marrëdhëniet e tij me kolegët, administratën gjyqësore, palët në proces dhe përfaqësuesit e tyre, median dhe publikun;
  - d) shmang sjelljet që bien në kundërshtim me ligjin dhe bën përpjekje që të shmangë çdo sjellje që tregon mungesë ndjeshmërie apo kujdesi;
  - dh) shmang çdo përfitim personal, për vete, familjarë apo të tjerë, që i vijnë për shkak të detyrës si gjyqtar dhe nuk lejon me vetëdije që të tjerët të japin përshtypjen se kanë një pozicion të veçantë për të pasur ndikim të papërshtatshëm në ushtrimin e detyrës së gjyqtarit;
  - e) nuk kërkon dhe as pranon dhurata, hua apo favore për vete ose anëtarët e familjes së tij, që i vijnë për shkak të ushtrimit të detyrës;
  - ë) nuk lejon me vetëdije anëtarët e familjes, personelin e gjykatës apo të tjerë, të kërkojnë ose pranojnë dhurata, hua apo favore, që iu bëhen për shkak të ushtrimit të detyrës së gjyqtarit;
  - f) mund të marrë dhurata simbolike, çmime ose përfitime, sipas rastit për të cilin jepet, me kusht që dhurata, çmimi apo përfitimi, të mos perceptohen nga një vëzhgues i arsyeshëm, si shkak njëanshmërie apo si qëllim për të ndikuar te gjyqtari në ushtrimin e detyrës;
  - g) mund të pranojë dekorime dhe tituj nderi, vetëm kur pranimi i tyre nuk ngre dyshime të arsyeshme për njëanshmëri ose cenim të pavarësisë së gjyqtarit.

### Ç. Parimi i Sjelljes së Hijshme dhe me Vetëpërmbajtje

9. Gjyqtari shmang sjelljen e pahijshme dhe shfaqjen e saj në të gjitha aktivitetet e tij. Si subjekt i vëzhgimit të vazhdueshëm publik, gjyqtari duhet të pranojë kufizime personale që mund të shihen si të paarsyeshme për një qytetar të thjeshtë dhe këtë duhet ta bëjë lirshëm dhe me dëshirë. Gjyqtari shmang çdo sjellje, e cila krijon dyshimin e arsyeshem se vendimet e tij nxiten nga motive të tjera, përtej zbatimit të drejtë të ligjit. Gjyqtari sillet me vetëpërmbytje me synim arrijten e një balance mes të drejtave të tij si qytetar dhe kufizimeve që lidhen me funksionin e tij. Sipas këtij parimi, gjyqtari:
- a) përpiqet në maksimum të mos cenojë besimin që publiku ka tek ai në ushtrimin e detyrës dhe në jetën e tij private;
  - b) duhet të respektojë dinjitetin e funksionit. Si çdo qytetar tjetër, ai gëzon lirinë e shprehjes, besimit, tubimit dhe organizimit, por në ushtrimin e këtyre të drejtave, ai duhet të sillet gjithmonë në mënyrë të tillë që të ruajë dinjitetin e funksionit, paanshmërinë dhe pavarësinë e gjyqësorit. Ai tregon po të njëjtin kujdes kur përballet me kritika apo sulme;
  - c) nuk lejon që zyra e tij të përdoret për qëllime të tjera të ndryshme nga ato që lidhen me ushtrimin e veprimtarisë gjyqësore;
  - ç) mban veshur togën gjyqësore gjatë ushtrimit të funksionit në salla gjykimi apo hapësira të tjera që i zëvendësojnë ato, ndërsa në raste të tjera, gjatë kohës së punës ose kur vepron si përfaqësues i gjyqësorit, i përmbahet rregullave të veshjes formale;
  - d) duhet t'i kërkojë personelit administrativ të gjykatës që mbështet veprimtarinë e tij gjyqësore, të zbatojë për aq sa është e mundur, rregullat e këtij Kodi gjatë kryerjes së detyrave të tyre. Një gjyqtar nuk duhet të orientojë personelin e gjykatës që të angazhohet në veprime në emër të gjyqtarit ose si përfaqësues i tij, kur kjo sjellje do të binte ndesh me këtë Kod nëse këto veprime do të kryheshin nga vetë gjyqtari;
  - dh) nuk duhet të përdorë informacionin konfidencial për të cilin gjyqtari vihet në dijeni për shkak të detyrës apo ta zbulojë atë për ndonjë qëllim tjetër që nuk lidhet me ushtrimin e detyrës;
  - e) nuk mund të nxisë krijimin, pjesëmarrjen, ose të anëtarësohet në ndonjë organizatë që mbështet çfarëdolloj diskriminimi, kërkon betim solemn për besnikëri, nuk ka transparencë të anëtarësisë apo që mban qëndrim denigrues ndaj gjykatave ose shtetit demokratik dhe të së drejtës;
  - ë) nuk mund të përfshihet në një veprimtari apo organizata që shfrytëzojnë anëtarësinë e gjyqtarit për të përfituar;
  - f) nuk duhet të shfrytëzojë pozitën e tij si gjyqtar për mbledhjen e mjeteve financiare, kur ai merr pjesë në aktivitete shoqërore, bamirësie apo fetare;
  - g) duhet të shmangë shfaqjen e bindjeve të tij politike edhe pse ai si çdo qytetar, gëzon të drejtën për të pasur të tilla;
  - gj) duhet të shfaqë vetëpërmbytje edhe në marrëdhëniet e tij me median. Për çështje që lidhen me marrëdhëniet me median, gjyqtari komunikon me gjyqtarin e medias të juridiksionit përkatës, duke shmangur çdo shfrytëzim të njohjeve personale me gazetarët;
  - h) vetëpërmbahet dhe nuk i komenton publikisht vendimet e tij, edhe nëse ato kritikohen nga media apo akademikë, ose prishen nga gjykatat më të larta. Gjyqtari e shpreh mendimin e tij vetëm në arsyetimin e vendimit të marrë;
  - i) nuk duhet të publikojë, në asnjë formë, si kontribut personal apo akademik, vendimet gjyqësore të dhëna prej tij si gjyqtar i vetëm apo si pjesë e trupës gjyqësore, me përjashtim të rastit kur pjesë të vendimit citohen për qëllime debati akademik, sipas rregullave të referimit;
  - j) mund të marrë pjesë në aktivitete që lidhen me sistemin gjyqësor dhe mund të bëjë vetëm deklarata të përgjithshme në kuadër të pjesëmarrjes në këto aktivitete. Gjyqtari mund të marrë pjesë edhe në aktivitete që nxitin vlerat qytetare, edukuese, fetare,

bamirësie, si dhe mund të bëjë deklarata përgjithshme vetëm në kuadër të pjesëmarrjes në këto aktivitete, por pa cenuar pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqësorit;

- k) shfaq vetëpërmbytje në përdorimin e medias dhe rrjeteve sociale;
- l) duhet të mos e përdorë statusin e tij si gjyqtar në jetën e tij private. Ai nuk duhet të krijojë përshtypje që do të ushtrojë pushtet mbi palët e treta, apo t'i bëjë ata që të mendojnë se gjyqtari, edhe në nivel personal, ka të drejtë të ushtrojë pushtet që ia atribuon ligji gjatë veprimtarisë dhe administrimit gjyqësor.

#### **D. Parimi i Kujdesit të Duhur dhe Profesionalizmit**

- 10. Gjyqtari i kryen me kujdes dhe efikasitet detyrat e tij në kohë dhe pa vonesë. Funkcionet gjyqësore ushtrohen me nivelin më të lartë të aftësive profesionale. Profesionalizmi, sikundër edhe kujdesi i duhur, janë parakushte për kryerjen e detyrave gjyqësore. Ushtrimi i funksioneve nga ana e gjyqtarit ka përparësi mbi të gjitha aktivitetet e tjera. Sipas këtij parimi, gjyqtari:
  - a) i trajton dhe gjykon çështjet brenda një afati të arsyeshëm të përshtatshëm për çështjen në fjalë, pa cenuar cilësinë e vendimit. Për secilën procedurë, atje ku ligji nuk parashikon shprehimisht, ai kujdeset që të përcaktojë afate të arsyeshme për palët dhe për veten e tij;
  - b) siguron administrim të drejtë të procesit gjyqësor dhe ndërvepron me profesionalizëm me administratën gjyqësore;
  - c) i kushton kujdes çdo pretendimi të bërë për shkeljen e të drejtave të një pale ose të një dëshmitari, duke përfshirë edhe pretendimet për keqtrajtim;
  - ç) ia kushton veprimtarinë profesionale ushtrimit të funksionit dhe administrimit të drejtësisë;
  - d) kujdeset që angazhimi i tij në veprimtari jashtëgjyqësore të mos cenojë kryerjen me përkushtim të detyrave gjyqësore;
  - dh) synon në mënyrë të vazhdueshme të arrijë nivele të larta të aftësive profesionale;
  - e) ndërmerr hapa të arsyeshëm për të ruajtur dhe rritur njohuritë, aftësitë dhe cilësitë personale, të nevojshme për kryerjen e detyrave gjyqësore;
  - ë) kujdeset për zhvillimin e aftësive të tjera, në përshtatje të risive teknologjike që ndikojnë në punën e tij;
  - f) informohet rregullisht në lidhje me zhvillimet e së drejtës ndërkombëtare, të detyrueshme për zbatim në Republikën e Shqipërisë;
  - g) bashkëpunon dhe ndërvepron me kolegët për shkëmbimin e përvojës dhe njohurive profesionale;
  - gj) duhet të shfaqë përkushtim të posaçëm ndaj përgjegjësive të tij si Kryetar apo Zëvendës Kryetar i Gjykatës, krahas veprimtarisë së tij gjyqësore. Gjyqtari me funksion drejtues duhet të tregojë shkallë të lartë përgjegjësie, aftësi organizative, drejtuese dhe komunikimi më të gjithë përdoruesit e gjykatës. Ai duhet të marrë masa për të garantuar aksesin e publikut në gjykatë, duke përfshirë edhe aksesin për personat me aftësi ndryshe;
  - h) gjatë ushtrimit të funksionit drejtues, në marrëdhënie me të tretët, duhet të mbrojë imazhin e drejtësisë, të tregojë seriozitetin dhe dinjitetin që publiku pret nga sistemi gjyqësor.

#### **DH. Parimi i Respektit dhe Aftësisë për të Dëgjuar**

- 11. Gjyqtari duhet të tregojë respekt dhe vëmendje ndaj personave dhe dinjitetit të tyre. Ai duhet t'i kushtojë vëmendje prezantimit të fakteve dhe arsyetimit ligjor të paraqitur nga palët dhe mbrojtësit e tyre. Sipas këtij parimi gjyqtari:
  - a) sillet në një mënyrë dinjitoze, korrekte, të respektueshme dhe mirëkuptuese në marrëdhëniet e tij me përdoruesit e gjykatës, kolegët e tij dhe stafin administrativ;

- b) dëgjon me vëmendje dhe merr parasysh në organizimin e punës së tij, kërkesat e të gjithë atyre që preken nga çështja;
- c) synon të krijojë një atmosferë të qetë në çdo ambient të gjykatës që përdor për ushtrimin e funksionit;
- ç) mban marrëdhënie korrekte me kolegët duke respektuar mendimin e tyre;
- d) respekton ushtrimin e detyrave dhe kompetencave prej stafit administrativ;
- dh) siguron që vlerat e respektit dhe të dëgjuarit të ndahen dhe respektohen nga të gjithë, gjatë kryerjes së detyrave të tij administrative.

#### **E. Parimi i Trajtimit të Barabartë**

12. Trajtimi i barabartë i qytetarëve nga gjykata është thelbësor për performancën e duhur të sistemit gjyqësor. Sipas këtij parimi, gjyqtari:
- a) përmbush funksionet e tij në respekt të plotë të parimit të trajtimit të barabartë të palëve. Ai shmang çdo paragjykim dhe diskriminim duke siguruar që çdo palë të dëgjohet në seancë në mënyrë të ekuilibruar;
  - b) synon të shmangë situatat në të cilat individët mund të ndiejnë se po ndërmerret një qasje e njëanshme dhe t'i adresojë këto situata në një mënyrë që të rritë besimin dhe respektin e publikut për gjykatën;
  - c) respekton individualitetin e gjithsecilit, duke garantuar trajtimin e barabartë si gjatë proces, ashtu edhe në përfundim të çështjes;
  - ç) sillet në mënyrë të tillë që askujt të mos i krijohet përshtypja se është injoruar, përkrahur apo përbuzur;
  - d) duhet të përcjellë tek gjyqtari i medias në mënyrë transparente dhe jodiskriminuese të gjitha informacionet që ky i fundit ndan me median dhe publikun.

#### **Ë. Parimi i Transparencës**

13. Publiku duhet të informohet mbi funksionimin e sistemit gjyqësor. Sipas këtij parimi gjyqtari:
- a) arsyeton vendimet e tij në një gjuhë të qartë dhe të kuptueshme;
  - b) siguron transparencë përmes seancave publike, në ruajtje të konfidencialitetit dhe respektimit të privatësisë ose rendit publik;
  - c) nuk abuzon me kërkesën për transparencë për ta shndërruar ushtrimin e funksionit në një shfaqje publike.

### **III. MBIKQYRJA E ZBATIMIT TË KODIT TË ETIKËS**

14. Çdo gjyqtar ka të drejtë të kërkojë nga Këshilltari për Etikën një opinion këshillimor për çështje të diskutueshme të etikës, lidhur me sjellje apo veprime të caktuara gjatë ushtrimit të funksionit apo jashtë tij, nëse ato konsiderohen ose jo në pajtim me standardet e etikës dhe rregullat e sjelljes. Interpretimi i standardeve etike dhe rregullave të sjelljes nga Këshilltari për Etikën, lidhur me faktin nëse rregulli përkatës e lejon një sjellje të caktuar, mund të përdoret si mjet mbrojtjeje nga ana e gjyqtarit në rast procedimi disiplinor, por ky interpretim nuk ka karakter detyrues për zgjidhjen e rasteve të tjera të ngjashme nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.
15. Kryetari i gjykatës mbikëqyr respektimin e etikës gjyqësore dhe raporton çdo problematikë në Këshillin e Lartë Gjyqësor në kuadër të informacionit periodik që i kërkohet.
16. Shkelja e rregullave të këtij Kodi kur nuk përbën shkak për përgjegjësi disiplinore merret në konsideratë në kuadër të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit.